

# Statistikat afatshkurtra

## Prodhuesit e të mirave - Tremujori II 2021


**Tiranë, më 16 Shtator 2021:** Treguesit tremujorë mbi prodhuesit e të mirave, përfshijnë aktivitetet ekonomike: Industri (Industri Nxjerrëse dhe Industri Përpunuese); Energji elektrike, Gaz, Avull; Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve; Ndërtim, në tremujorin e dytë 2021, paraqiten si më poshtë:

### Industri

Indekset e treguesve në aktivitetin Industri, në tremujorin e dytë 2021, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 54,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 46,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 3,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 18,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Industri (%)




Për publikim 16/09/2021

### Energji elektrike, Gaz, Avull

Indekset e treguesve në aktivitetin Energji elektrike, Gaz, Avull, në tremujorin e dytë 2021, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 64,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 69,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 2,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 5,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig.2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Energji elektrike, Gaz, Avull (%)




### Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve

Indekset e treguesve në aktivitetin Furnizimi me ujë dhe Trajtimi e menaxhimi i mbetjeve, në tremujorin e dytë 2021, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 45,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 31,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rënie 5,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 2,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 3 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Furnizimin me ujë, Trajtimi e menaxhimi i mbetjeve (%)




**Ndërtim**

Indekset e treguesve në aktivitetin Ndërtim, në tremujorin e dytë 2021, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 32,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 32,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 4,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 11,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 4 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto, Ndërtim (%)



**Tab. 1 Indeksi i shitjeve neto në volum, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.II 2021 (2015=100)	II.21 / II.20 (%)	Tr.II 2021 (2015=100)	II.21 / I.21 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	<b>130,4</b>	<b>54,1</b>	<b>134,2</b>	<b>15,4</b>
B	05-09	Industri nxjerrëse	81,9	57,7	85,8	16,5
C	10-33	Industri përpunuese	155,1	52,7	153,7	11,9
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	168,9	64,9	171,1	17,8
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	116,7	45,5	112,1	5,1
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	<b>170,7</b>	<b>32,2</b>	<b>172,6</b>	<b>27,0</b>
<b>Grupimet industriale kryesore</b>						
		Mallra të ndërmjetme	171,6	62,1	171,1	20,9
		Energji	131,4	76,2	136,2	18,5
		Mallra kapitale	173,2	58,8	177,0	18,6
		Mallra të qëndrueshme konsumi	142,3	75,4	150,9	17,1
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	113,5	24,8	115,3	5,1

**Tab. 2 Indeksi i prodhimit në volum, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.II 2021 (2015=100)	II.21 / II.20 (%)	Tr.II 2021 (2015=100)	II.21 / I.21 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	<b>116,8</b>	<b>46,9</b>	<b>118,7</b>	<b>14,4</b>
B	05-09	Industri nxjerrëse	90,4	66,6	94,0	26,9
C	10-33	Industri përpunuese	138,2	39,5	140,6	10,9
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	106,3	69,0	99,5	-0,3
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	108,3	31,0	104,7	3,4
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	<b>176,3</b>	<b>32,6</b>	<b>178,0</b>	<b>23,5</b>
<b>Grupimet industriale kryesore</b>						
		Mallra të ndërmjetme	149,0	49,6	145,6	16,1
		Energji	98,5	83,5	95,4	11,3
		Mallra kapitale	213,3	64,1	210,8	2,7
		Mallra të qëndrueshme konsumi	137,6	65,1	151,7	17,5
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	110,7	19,4	115,6	7,5

**Tab. 3 Indeksi i numrit të të punësuarve dhe fondit të pagave, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2			Numri i të të punësuarve		Fondi i pagave	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.II 2021 (2015=100)	II.21 / II.20 (%)	Tr.II 2021 (2015=100)	II.21 / II.20 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	<b>104,5</b>	<b>3,4</b>	<b>130,4</b>	<b>18,2</b>
B	05-09	Industri nxjerrëse	78,5	-4,8	96,4	4,7
C	10-33	Industri përpunuese	108,4	4,3	142,5	21,1
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	111,8	-2,2	184,2	5,9
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	114,5	-5,1	144,7	2,1
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	<b>123,8</b>	<b>4,1</b>	<b>141,2</b>	<b>11,2</b>

# Metodologjia

## Informacion

Në vazhdim të përpjekjeve të përafrimit dhe standardizimit të statistikave afatshkurtra me statistikave evropiane, INSTAT publikon Statistikat Afatshkurtra –Të mira si më poshtë :

- Indekset duke filluar nga tremujori i parë 2019, do të llogariten me vit bazë 2015=100.
- Peshat janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës Strukturore e Ndërmarrjeve për vitin 2019, realizuar nga INSTAT.

## Informacion mbi vrojtimin

**Qëllimi** - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

### Në prodhuesit e të mirave:

**Fusha e mbulimit** - Bazuar në aktivitetin kryesor, në anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
- Energji elektrike, gaz, avull (35)
- Furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve (36-39)
- Ndërtim (41, 42, 43)

**Modeli** - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

**Mbledhja e informacionit** - Për këtë tremujor janë përdorur burimet administrative dhe intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

**Treguesit** - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2015=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

**Indekset** - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

**Ndryshimi vjetor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

*Ndryshimi tremujor në përqindje* - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

**Rishikimi** – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur, etj.

**Përkufizimet e treguesve kryesorë**

*Shitjet neto* - *Shitjet neto* përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar.

*Indeksi i shitjeve neto* - Objektivi i indeksit të *shitjeve neto* është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime.

*Numri i të punësuarve me pagesë* - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përfshirë të vetëpunësuarit me pagesë).

*Paga dhe trajtime* - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimit (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

*Indeksi i fondit të pagave* - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

**Grupimet Industriale Kryesore** janë një rigrupim i aktiviteteve Industri Nxjerrëse, Industri Përpunuese dhe Energji të detajuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2), si më poshtë:

Grupimet Industriale Kryesore	NVE Rev.2
Mallra të ndërmjetme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 07-09 Nxjerrja e mineraleve natyrore; Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat; Aktivitete mbështetëse minerare</li> <li>• 13000 Përpunimi i tekstileve</li> <li>• 16000 Prodhimi i drurit dhe materialeve prej druri, përveç mobiljeve</li> <li>• 17000 Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre</li> <li>• 20-21 Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike; Përpunimi i produkteve farmaceutike</li> <li>• 22000 Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës</li> <li>• 23000 Prodhimi i produkteve minerale jo metalike</li> <li>• 24000 Metalurgjia</li> <li>• 255XX Farkëtimi, stampimi, petëzimi dhe trafilizimi i metaleve</li> <li>• 27000 Prodhimi i pajisjeve elektrike</li> </ul>
Energji	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 05-06 Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve; Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror</li> <li>• 19000 Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës</li> <li>• 35000 Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri i kondicionuar</li> </ul>
Mallra kapitale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 251XX Prodhimi i produkteve metalike strukturore</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 262XX Prodhimi i kompjuterave dhe pajisjeve periferike</li> <li>• 28000 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t</li> <li>• 33000 Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve</li> </ul>
Mallra të qëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 264XX Prodhimi i produkteve elektronike për konsumatorët</li> <li>• 31000 Prodhimi i mobiljeve</li> <li>• 32XXX Industri të tjera p.k.t</li> </ul>
Mallra të paqëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 10000 Përpunimi i produkteve ushqimore</li> <li>• 11-12 Prodhimi i pijeve; Prodhimi i produkteve të duhanit</li> <li>• 14000 Konfeksionimi i veshjeve</li> <li>• 15000 Prodhimi i lëkures dhe produkteve prej lëkure</li> <li>• 18000 Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara</li> <li>• 32YYY Industri të tjera p.k.t</li> </ul>

### Përshtatja sezonale

Përshtatja sezonale në seritë tremujore të prodhimit të të mirave materiale u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2.0. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2006 - Tremujori II 2021. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Në metodën multiplikative ekziston një lidhje midis komponentit të trendit, komponentit sezonal dhe komponentit irregular, ku ky i fundit shpjegon ato pjesë të serisë kohore të cilat nuk mund të parashikohen dhe janë të pazakonshme. Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave afatshkurtra. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.